



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.175/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialeve promovuse të kandidatit të tyre në afërsi të objekteve publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 04.10.2019, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.175/2019 e datës 01.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialeve promovuse të kandidatit të tyre në afërsi të objekteve publike.

A r s y e t i m

Me datën 01.10.2019, Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 01.10.2019 rreth orës 07:30, në hyrje të Rezidencës së Ipeshvis janë parë materiale promovuese të kandidati të LDK-së, për deputet Besian Murati i cili mbanë numrin shtatë, materialet në fjalë janë të vendosura dy metra larg hyrjes së Rezidencës në fjalë. Se ato janë të kapura pran hyrjes se këtij objekti fetar vërtetohet me fotot dhe videot të cilat ua kemi bashkangjitur me ankesë. Me këtë rast parashtuesi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 33 pika b të LZP-së, dhe po ashtu shkelje e Rregullores Nr.13/2013, “Fushata e Zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike”, përkatësisht nenit 3.4 dhe nenit 4 pika b. Parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur një fotografi dhe një video.

Në përgjigjen në ankesë të datës 02.10.2019, subjekti politik LDK, thekson se ankesa e paraqitur nga organizata BIRN dhe IKS me Anr.175/2019, me date 01.10.2019 është e pabazë, e pa drejt dhe se nuk përmban prova se ekziston ndonjë shkelje, më tutje thekson se ne foto dhe ne video shihet vetëm numri shtatë dhe se nuk ka as një element tjetër, emër, mbiemër, subjekt apo mbishkrim tjetër veç numrit shtatë. Pavarësisht subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ju njofton që ka ndërmarr masat e duhura dhe ka evituar “shkeljen e supozuar” nga se respekton Urdhrin e PZAP, gjegjësisht nenin 120.1 të LZP-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se pretendimet e paraqitësit të ankesë janë të pabazuar, dhe nuk përbëjnë shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së.

Lidhur me pretendimet e parashtresit të ankesës se materiali zgjedhor saktësisht numrin shtat i kandidatit Besian Mustafi nga radhët e LDK në afërsi të katedrales në perimetrin prej dy metra larg hyrejes së Ipeshvis së kosoves, paneli vlerëson se në këtë periudhë kohore këto veprime nuk janë në kundërshtim me dispozita ligjore ngase këto veprime janë të ndaluara vetëm para fillimit të votimit dhe gjatë ditës së zgjedhjeve, nëse objekti në të cilën pretendohet se është i vendosur posteri 13 metra larg shërben si Qendër e Votimit, sipas nenit 85 paragrafi 1 të LZP-së, në të cilin përcaktohet, se: *“Të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilitdo VV ose QV në rreze prej 100 metra, çfarëdo materiali i tillë i mbetur 24 orë para fillimit të votimit duhet të largohet nga anëtarët e KVV-ve ose Menaxheri i QV-së. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar dhe/ose janë gjetur duke postuar material të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të vendosur duhet të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji”*

Periudha kohore për të cilën parashihet të aplikohet dispozita e lart cituar ligjore është 24 orë para procesit të votimit dhe gjatë ditës së votimit, nëse objekti në të cilën pretendohet se është vendosur posteri afër tij shfrytëzohet si qendër e votimit në ditën e votimit, andaj paneli erdhi në përfundim se pretendimet e paraqitësit të ankesës, janë të paqëndrueshme dhe bazuar në arsyet e theksuar më lartë, dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.175/2019 më datën 04.10.2019

Kryesuesi i Panelit

Fejzullah Rexhepi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.